



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1093/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me shenjë ZL.Anr.1093/2017 e datës 19.11.2017, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1000 (*njëmijë*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 19.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) me të cilën ka pretenduar se me datë 19.11.2017, në ora 08:36 para ditës, përmes faqes së rrjetit social Facebook ka bërë thirrje për komunitetin boshnjak për ta votuar kandidatin Shaqir Totajn nga radhët e subjektit politik PDK. Ka theksuar se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur (2) *dy* fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Subjekti politik VAKAT në përgjigjen në ankesë të datës 20.11.2017, ka theksuar se, me rastin e thirrjes së komunitetit tim për ta votuar kandidatin Shaqir Totaj nga radhët e subjektit politik PDK në komunën e Prizrenit, nuk ka qenë në dijeni se në faqen e rrjetit social Facebook, nga profili personal i Facebook-ut, paraqitet shkelje e rregullave zgjedhore që kanë të bëjnë me thyerje të heshtjes zgjedhore. Më tutje ka theksuar se, nuk janë kryetare, ashtu siç cilësohem nga parashtruesi i ankesës, por janë vetëm anëtare nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Boshnjakëve (DSB) apo koalicionit VAKAT, duke shtur se ky cilësim nga ana e ankuesit të ankesës, paraqet rrethanë rënduese për mua, prandaj ka

konsideruar se një thirrje e tillë nuk paraqet thyerje të heshtjes zgjedhore dhe PZAP-it i ka kërkuar që ankesën e parashtruesit ta refuzoj si të pa bazuar.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në përgjigjen në ankesë të datës 21.11.2017 ka theksuar se Duda Bala është anëtare nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Boshnjakëve (DSB) në Prizren dhe deputete e Kuvendit të Kosovës, prandaj subjekti politik PDK nuk mban përgjegjësi për deklaratimet publike të partive tjera dhe anëtarëve të tjerë. Më tutje thekson se ashtu sikur në rastet e tjera të publikimeve përmes faqes së rrjetit social Facebook, asnjë subjekt politik madje as subjekti politik PDK nuk mund të jetë përgjegjës për veprimet nëpërmjet rrjeteve sociale të anëtarëve të vet, dhe PZAP-it i ka kërkuar që pretendimet e tilla ti refuzoj si të pa bazuara.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se në profilin e Duda Balje nga faqja e rrjetit social Facebook, ka konfirmuar një postim në ditën e heshtjes zgjedhore konkretisht me datë 19.11.2017 në orën 8:36 minuta, i cili postim ka në përmbajtje fotografinë e kandidatës Duda Balje, në takim me kandidatin për kryetar të komunës së Prizrenit nga radhët e subjektit politik PDK, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Sa i përket pretendimeve të subjektit politik PDK se nuk mban përgjegjësi pasi që Duda Bala është anëtare nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Boshnjakëve (DSB) në Prizren dhe deputete e Kuvendit të Kosovës. Me këtë rast Paneli konstaton se Duda Bale në cilësinë e përkrahësit dhe mbështetësit të kandidatit të PDK-së për kryetar të komunës së Prizrenit gjatë heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë për kandidatin e PDK-së Shaqir Totaj dhe në mbështetje të tij.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik PDK, është përgjegjës për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së PDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e

tyre dhe kandidatet, që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.1093/2017 më datën 21.11.2017



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*